



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT NË RAST**

**FATKEQËSIE
Z.ROBERT GEGA**

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtorinë e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga Z. Robert Gega me Nr.122 Prot datë 12.02.2020 mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24, /1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c ; ligjin 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.66 datë 26.12.2019 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe PBA përfundimtare 2020-2022”.

JU RELATOI:

Të nderuar Këshilltar !

Familja e Robert Sami Gega është një familje në nevojë, me probleme sociale ekonomike dhe shëndetësore. Kjo familje përbehej nga dy anëtare deri në momentin e vdekjes së bashkëshortes Brunilda Gega, prej sëmundjes së diabetit melitus dhe komplikacioneve të tjera që sjell kjo sëmundje.

Banesa që zotëron familja Gega është një banesë e marrë me qera e cila paguhet nëpërmjet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

që ka aktualisht familja Gega janë vetëm nga Njihma Ekonomike në masën 1800 (një mijë e tetëqind) lekë.

Me vdekjen e bashkëshortes Z.Robert trashëgoi shumë borxhe pasi u përpoq ta kuronte zonjën në çdo lloj forme, pavarësisht vështirësive ekonomisë që trashëgoi prej vitesh. Tashmë familja gjendet në një situatë shumë të vështirë ekonomike dhe psikologjike e cila ka nevojë të ndihmohet për të përballuar një pjesë të shpenzimeve të varrimit.

Bashkëngjiur relacionit keni dokumentacionin: kërkesë, certifikatë vdekje/familjare para vdekjes dhe aktuale, vërtetimin për përfundimin e ndihmës ekonomike, kartë identiteti, mandat pagese për shpenzimet e funeralit, relacionin social-ekonomi të familjes.

PRGJ/SEK
Piro Xheplati

DREJTORI I SHËRBIMIT SOCIAL
Juvina Qevani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

KËSHILLI I BASHKISË

PROJEKT VENDIM

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT NË RAST
FATKEQËSIE
Z.ROBERT GEGA**

Kryetari i Bashkisë pasi u njoh me materialin e përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24, /1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c ; ligjin 68/2017 date 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë ”, VKB nr.66 datë 26.12.2019 “Për miratimin e buxhetit te vitit 2020 dhe PBA përfundimtare 2020-2022”.

PROPOZOI:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpezimeve të varrimit në rast fatkeqësie (vdekje) për shtetasin Robert Gega në shumën 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë.
2. Shuma prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë do të përballohet nga buxheti i Bashkisë për vitin 2020.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Social.